

“DETYRA E  
RINIŠË ËSHTË  
QË TA SFIDOJË  
KORRUPSIONIN.”

KURT COBAIN

## ÇFARË ËSHTË KORRUPSIONI?

Çdo keqpërdorim i pushtetit apo sjellje tjetër e personit zyrtar, personit përgjegjës apo ndonjë personi tjetër me qëllim të arritjes së një përparësie apo përfitimi të kundërligjshëm për veten e tij apo për të tjerët paraqet korrupsion. Me fjalë të tjera, korrupsioni paraqet shpërdorim të fuqisë publike për përfitime personale.



Qendra për studime të avancuara FIT  
E-mail: [info@fit-ks.org](mailto:info@fit-ks.org)  
[www.fit-ks.org](http://www.fit-ks.org)



Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet=konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit



ROLI I RINIŠË  
NË LUFTËN KUNDËR  
**KORRUPSIONIT**



## PSE ËSHTË RINIA AJO QË DUHET TA LUFTOJË KORRUPSIONIN?

- Rinia është pjesa që përfaqëson numrin më të madh të popullatës në botë. Prandaj, është pikërisht rinia që mund të jetë lider i çdo ndryshimi.
- Të rinjtë e sotëm janë liderët e së ardhmes, andaj është roli i tyre që ta luftojnë korrupsionin.
- Rinia është e shpejtë në mësim dhe poashtu në veprim.
- Moshë rinore është ajo që mund të manipulohet më lehtë. Shansat që të rinjtë të jenë viktimë të korrupsionit janë më të mëdha, kështu që rinia duhet të jetë shumë aktive në luftën kundër korrupsionit.
- Përveç që kërcënon dhe ndalon zhvillimin ekonomik të një vendi, korrupsioni është ai që kërcënon edhe sigurinë shtetërore. Me këtë rast, të rinjtë nuk duhen që ta kenë vetëm opsion luftën kundër korrupsionit, por duhen ta marrin si detyrim ndaj vendit që ta luftojnë këtë fenomen.



## SI TA LUFTOJË RINIA KORRUPSIONIN?



- Integriteti, ashtu si korrupsioni, mësohet.
- Të rinjtë janë edhe më të shpejtë për të mësuar aktet e drejta se sa ato të gabuara. Prandaj, duke fuqizuar aktet e drejta, të rinjtë drejtpërdrejtë e luftojnë korrupsionin.
- Në mënyrë që ta mbrojnë vetveten, rinia duhet të jetë e motivuar që të marrë pjesë në organizime të shumta të cilat bëhen me objektivin që të luftojnë korrupsionin.
- Arsimi është thelbësor për parandalimin e korrupsionit, për këtë arsye rinia duhet që arsimin ta ketë prioritet.
- Të rinjtë duhet që me këmbëngulësi të kërkojnë fuqizimin e tyre në luftën kundër korrupsionit.

Vizioni i të rinjve për një të ardhme më të mirë për vendin e tyre po i motivon këta të rinj që të bashkohen në forume dhe nisma të ndryshme në luftën kundër korrupsionit. Gjatë vitit 2015, Qendra për Studime të Avancuara FIT, ka zhvilluar disa ligjërata drejtuar nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme se si të luftojnë korrupsionin. Në vijim, Qendra FIT ka themeluar edhe grupin: **“Ambasadorët e Rinj në Luftën Kundër Korrupsionit”** pjesë e të cilit janë nxënësit aktivë dhe me motiv për punë. Ky angazhim nga të rinjtë nuk bëhet për interesa të tyre personale, por për kthimin e dinjitetit të vendit të tyre dhe për një ambient më të mirë për të jetuar.

## PËRVOJAT E TË RINJVE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT!

